



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2022

**VENDIM**

**Nr. 248, Datë 06.07.2022**

**PËR  
PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT  
{...} NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” i ndryshuar, në vendimet nr. 257, datë 17.06.2021 dhe nr. 295, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsiderate dhënien e pëlqimit të gjyqtarit {...} protokolluar pranë Këshillit, me nr. 3743/2 prot., datë 04.07.2022, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, për një periudhë deri në 1 (një) vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 01.07.2022.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**